



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 shtator 2019
Nr. Ref.:RK 1423/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI39/18

Parashtrues

Bujar Hoti

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit C. nr. 180/08, të 19 shtatorit 2014 dhe Aktgjykimit C. nr. 203/18, të 5 shtatorit 2018, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gérxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Bujar Hoti nga fshati Polac, komuna e Skenderajt (në tekstin e mëtejmhë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kérkesës fillimisht ka kontestuar Aktvendimin C. nr. 180/08, të 19 shtatorit 2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc dhe pastaj në dokumentet shtesë me të cilën ka plotësuar kérkesën ka kontestuar Aktgjykimin C. nr. 203/18 të 5 shtatorit 2018 të po kësaj gjykate si vendim të fundit gjyqësor të cilin ai e ka pranuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kérkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit dhe aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksiioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kérkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kérkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershori 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrimit të kérkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 13 mars 2018, parashtruesi e dorëzoi kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata). Parashtruesi dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë më 17 maj, 13 korrik dhe 8 shtator 2018, duke përfshirë këtu edhe Aktgjykimin C. nr. 203/18, të 5 shtatorit 2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc si vendim të fundit gjyqësor që parashtruesi e ka pranuar.
7. Më 20 mars 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović, gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrties të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu (anëtarë).
8. Më 8 maj 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kérkesës dhe i dërgoi një kopje të kérkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 16 qershori 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershori 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
11. Më 17 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin GJR. KI39/18 e caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare raportuese në këtë rast.
12. Më 24 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës nxori vendimin për zëvendësimin e Kolegjit shqyrtares dhe në Kolegji u caktuan: Arta Rama-Hajrizi, kryesuese, Bekim Sejdiu dhe Safet Hoxha, anëtarë.
13. Më 22 korrik 2019, Kolegji shqyrtares shqyrtoi reportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përbledhja e fakteve

14. Më 1 dhjetor 1998, parashtruesi i kërkesës, pronar i një banese banimi në Gllogoc, ka lidhur kontratë shitblerjeje me blerësin N. D. të cilin ia ka shitur banesën të përshkruar si në kontratë. Kontrata ishte përpiluar me shkrim dore, dhe sipas shkresave të lëndës nuk rezulton të jetë e vërtetuar në ndonjë gjykatë kompetente. Në kontratë theksohet se banesa që është objekt kontrate është ndërruar me banesën përballë që është në pronësi të një pale të tretë (H. L.) me madhësi të njëjtë dhe se shitësi i garanton blerësit dhe i jep përgjegjësi të plotë për secilën mosmarrëveshje eventuale në këtë drejtim.
15. Më 1 tetor 1999, në Prishtinë, parashtruesi kishte lidhur një kontratë tjeter shitblerjeje për të njëjtën banesë, tanë me M. K. për një çmim më të lartë se sa në kontratën e parë. Në këtë kontratë nuk kishte referenca për palët e treta të përfshira. Kontrata ishte përpiluar në zyrën e avokatit F. SH., ishte nënshkruar nga palët kontraktuese dhe ishte vërtetuar me vulën e avokatit. Nga kontrata konstatohet se parashtruesit i është paguar menjëherë çmimi i kontraktuar. Parashtruesi i kërkesës pohon se këtë kontratë e ka nënshkruar nën kërcënëm dhe pa dëshirën e tij.
16. Për çështjen juridike, lidhur me banesën kontestuese, ishin zhvilluar dy procedura paralele ku parashtruesi i kërkesës ishte palë. Njëra kishte filluar në Komisionin për Çështjet Banesore-Pronësore (KÇBP) pranë Drejtorisë për Çështjet Banesore-Pronësore (DÇBP-UN-Habitat) që vepronte në kuadër të Administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara-Misioni në Kosovë, si procedurë administrative dhe më pastaj ka vazduhar në gjykatë e iniciuar nga vetë parashtruesi i kërkesës dhe tjetra në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Dega në Gllogoc e iniciuar nga blerësi M. K.

Procedura në Komisionin për Çështjet Banesore-Pronësore (KÇBP) të DÇBP-UN-Habitat

17. Më 29 nëntor 2001, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur një kërkesë për paluajtshmërinë për banim në Komisionin për Çështjet Banesore-Pronësore (KÇBP) që vepronte pranë DÇBP-UN-Habitat. Në kërkesë parashtruesi kishte kërkuar që kontrata mbi shitblerjen me blerësin e dytë M. K. të konsiderohet si jo e ligjshme pasi që është lidhur nën presion, ndërsa që kontrata e lidhur me

blerësin e parë ose të përbushet në tërësi ose t'i kthehet banesa të cilën tashmë e kishte shitur.

18. Më 18 qershor 2005, KÇBP me vendimin grupor HPCC/D/204/2005/C kishte refuzuar kërkesën e paraqitur dhe vendosi që kërkesa t'i referohet gjykatës kompetente lokale.
19. Më 7 gusht 2008, Agjencia Kosovare e Pronës (AKP), si pasardhëse e DÇBP-së, kishte referuar çështjen në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc (në tekstin e mëtejjmë: Gjykata Themelore).
20. Më 19 shtator 2014, Gjykata Themelore me Aktvendimin C. nr. 180/08, hodhi parashtresën e AKP-së me arsyetimin se në kuptim të nenit 152 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashresa nuk i përbushë kriteret e padisë apo kérkesëpadisë në formë të shkruar.
21. Më 24 dhjetor 2014, parashtruesi i kérkesës, në gjykatën e shkallës së parë, paraqiti një shkresë në formë ankesë kundër Aktvendimit C. nr. 180/08 për Gjykatën e Apelit të Kosovës.
22. Më 23 janar 2018, me shkresën me nr. Ac. nr. 557/2015, Gjykata e Apelit ia ktheu shkresat e lëndës Gjykatës Themelore me arsyetimin se shkresa e palës paditëse nuk i përbushë kriteret e ankesës të parapara me nenin 178 të LPK-së.
23. Më 23 shkurt 2018, Gjykata Themelore, duke u bazuar në shkresën e Gjykatës së Apelit, nr. Ac. nr. 557/2015, i bëri thirrje parashtruesit të kérkesës që në afat prej 7 ditësh, ta plotësojë parashtresën e tij të 24 dhjetorit 2014.
24. Më 2 mars 2018, parashtruesi i kérkesës paraqiti plotësimin e kérkuar në formë ankesë në gjykatën e shkallës së parë për Gjykata e Apelit.
25. Më 22 mars 2018, Gjykata Themelore me Aktvendimin C. nr. 180/08 e hodhi poshtë si të palejueshme ankesën e paraqitur nga parashtruesi i kérkesës duke e cilësuar çështjen juridike për të cilën është paraqitur ankesa si çështje tashmë të gjykuar (*res judicata*) sipas padisë së parashtruar nga pala kundërshtare (M. K.).
26. Në një datë të pa specifikuar, parashtruesi i kérkesës paraqiti ankesë kundër aktvendimit të sipërpërmendor të Gjykatës Themelore.
27. Më 18 qershor 2018, Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac. nr. 557/2015 aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit, prishi aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Themelore, C. nr. 180/08 të 22 marsit 2018, dhe çështjen e ktheu në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata aktvendimin e arsyetoj me faktin se “*Nuk ka qenë detyrë e Gjykatës që në ketë rast të jap vlerësimin se a kemi të bëjmë me çështje të gjykuar por vetëm të vlerësoj se ankesa e paraqitur a i përban elementet-kushtet për të proceduar sipas saj, e pastaj çështjen t'ia dorëzoj gjykatës më të lartë për të vendosur lidhur me te. Në rrëthana të tillë gjykata është dashur që ankesën t'ia përcjell gjykatës më të lartë për ta vlerësuar atë ngase ankesa ka plotësuar kushte nga neni 178 të LPK-së për të proceduar*”.

28. Më 3 korrik 2018, Gjykata Themelore, duke vepruar sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në procedurën e rivendosjes, me Aktvendimin C. nr. 203/2018 vendosi që: I. kërkesa e parashtruar në gjykatë nuk i përmbushë kushtet për t'u trajtuar si padi, andaj i kthehet parashtruesit që në afat prej 3 ditësh ta plotësojë të njëjtën; II. urdhërohet parashtruesi që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi ta paguaj taksën gjyqësore në harmoni me dispozitat e Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).
29. Gjykata Themelore në dispozitivin e aktvendimit e paralajmëroi parashtruesin se në rast se nuk plotësohen kërkesat e gjykatës lidhur me plotësimin e parashtresës apo nuk paguhet detyrimi i taksës gjyqësore, gjykata do të konsiderojë se parashtruesi është tërhequr nga padia.
30. Më 11 korrik 2018, parashtruesi në Gjykaten Themelore dërgoi parashtresën për plotësimin dhe precizimin e padisë në harmoni me kërkesën që i është parashtruar me Aktvendimin C. nr. 203/18 të po asaj gjykate.
31. Më 5 shtator 2018, Gjykata Themelore mbi bazën e padisë së plotësuar, me Aktgjykimin C. nr. 203/18 vendosi çështjen në meritat e saj dhe refuzoi si të pathemeltë kërkesëpadinë.
32. Më 26 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, paraqiti ankesë në Gjykaten e Apelit të Kosovës.
33. Nga shkresat e kërkesës, Gjykata nuk mund të konstatojë se lidhur me ankesën të jetë marrë ndonjë vendim gjyqësor.

Proceduara e zhvilluar nga pala kundërshtare (blerësi M. K.)

34. Më 7 mars 2005, M. K. në cilësinë e blerësit të banesës kishte paraqitur propozim për vërtetimin e kontratës mbi shitblerje të banesës që ishte objekt kontratë në mes tij dhe parashtruesit të kërkesës.
35. Më 13 prill 2005, Gjykata Komunale në Gllogoc me Aktvendimin N. Nr. 19/2005 pezulloi procedurën lidhur me propozimin dhe propozuesin (M. K.), për realizimin e të drejtës së tij, e udhëzoi në kontest civil.
36. Më 20 prill 2005, M. K., në Gjykaten Komunale në Gllogoc, paraqiti padi për vërtetimin e marrëveshjes së shitblerjes së banesës.
37. Më 6 qershor 2005, Gjykata Komunale në Gllogoc nxori Aktgjykimin C. nr. 80/2005, me të cilin aprovoi kërkesëpadinë e M. K. dhe vërtetoi se paditësi është pronar i banesës në bazë të kontratës për shitblerjeje.
38. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë kundër Aktgjykimit të sipërpërmendor në Gjykaten e Qarkut në Prishtinë.
39. Më 3 korrik 2006, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 771/2005, refuzoi ankesën e parashtruar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gllogoc, C. nr. 80/2005, të 6 qershorit 2005.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

40. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet gjyqësore të kontestuara atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
41. Kërkesën e tij parashtruesi i kërkesës e ndërton mbi faktin se kontratën për shitblerje të banesës me M. K. e kishte lidhur nën presion dhe se me atë rast ishte dëmtuar financiarisht. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se gjykata nuk kanë qenë objektive me rastin e shqyrimit të parashtresave dhe ankesave të tij.
42. Sipas parashtruesit “*gjykimi bazohet në kontratë të dhunshme, vendimi 180/08; është i sajuar, vendimi nga Habitati i datës 28.07.2005 është një kamulfim*”.
43. Gjithashtu parashtruesi thekson se “*nuk më ka ofruar mundësinë për avokat, janë fshehur shumë fakte, si dhe se është tejkaluar koha e zgjedhjes së lëndës 1999-2018*”.
44. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata, që “*për dëm të më paguhen 20.000 euro, për maltretim, kohë, shpenzime gjyqësore 5000 euro*”. Si përfundim, parashtruesi kërkon që t'i kthehet banesa dhe të dënohen gjyqtarët që kanë vendosur në lëndën e tij.

Pranueshmëria e kërkesës

45. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
46. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksiioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh:
 1. “*Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar*”.
 7. “*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*”.
47. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë siç specifikohen më tej me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] dhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kérkesa individuale]

1. “Çdo individ ka të drejtë të kérkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.

Neni 48
[Saktësimi i kérkesës]

“Parashtruesi i kérkesës ka për detyrë që në kérkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

48. Sa i përket përbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kérkesës është palë e autorizuar, që konteston aktet e një autoriteti publik. Parashtruesi i kérkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur përmes vendimeve konkrete gjyqësore, në pajtim me kushtet që kerkohen nga neni 48 i Ligjit, si dhe ka dorëzuar kérkesën në pajtim me afatin e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara për shterjen e mjeteve juridike (neni 113.7 i Kushtetutës) sikurse edhe kriteret e parapara në nenin 47. par 2 të Ligjit [Kérkesa individuale], dhe në rregullin 39 (1) (b) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës të cilat, në mes tjerash, përcaktojnë:

Neni 47
[Kérkesa individuale]

2. “Individ mund ta ngritë kérkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

(1) *Gjykata mund ta konsiderojë një kérkesë të pranueshme nëse:*

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykit ose vendimit të kontestuar, [...]

49. Në këtë drejtim, Gjykata sjellë në vëmendje se pretendimi themelor i parashtruesit të kérkesës është shkelja e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe shkelja e drejtës së pronës, të dyja këto të drejta individuale të mbrojtura me nenet 31, respektivisht 46 të Kushtetutës së Kosovës, të cilat kanë përbajtjen si në vijim:

Neni 31 [E drejta në gjykim të drejtë e të paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

[...]

50. Gjykata rikujton se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), andaj, në rastet individuale kur Gjykata trajton shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut merr për bazë praktikën ligjore të GJEDNJ-së, dhe rrjedhimisht kur trajton shkeljen e pretenduar të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata i referohet edhe nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut [KEDNJ] i cili përcakton:

Neni 6.1 i KEDNJ-së [E drejta për një proces të rregullt]

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdoakuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e Gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

Rrjedhimisht, Gjykata i referohet edhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili imbron të drejtën e pronës i cili përcakton:

Neni 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

“(1) Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përvëçse për arsyet e interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

(2) Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.

Sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

51. Gjkata vë në pah se thelbi i kërkesës së parashtruesit konsiston në kontestin lidhur me një banesë e cila ishte objekt i dy kontratave për shitblerje. Parashtruesi i kërkesës, kontestin e kishte filluar në KÇBP të DÇBP-UN-Habitat dhe pastaj e kishte vazhduar në gjykatat e rregullta vendore me dy kërkesa themelore: a) që t'i kthehet e drejta pronësore mbi banesën, dhe b) të zhđemtohet për dëmin material që i është shkaktuar si pasojë e lidhjes së kontratës nën detyrim.
52. Gjkata gjithashtu konstaton se prej momentit të fillimit të kontestit të iniciuar nga parashtruesi në KÇBP të DÇBP-UN-Habitat, më 29 nëntor 2001 e deri më 3 korrik 2018, asnjëri nga institucionet kompetente (KÇBP-DÇBP-UN-Habitat dhe gjykatat e rregullta) nuk kishte nxjerrë vendim mbi meritat e kontestit por gjithmonë nxirreshin vendime mbi çështje procedurale lidhur me pranueshmérinë e padisë-kërkesëpadisë apo ankesave të parashtruara.
53. Gjkata gjithashtu konstaton se ishte Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, C. nr. 203/18, i 5 shtatorit 2018, i cili, bazuar në kërkesëpadinë e plotësuar të parashtruesit të kërkesës, vendosi lidhur me meritat e padisë.
54. Gjkata Themelore në Aktgjykimin si më sipër kishte konstatuar se padia ishte e pathemeltë sepse çështja e pronësisë mbi banesën që është objekt kontesti ishte vendosur me vendim gjyqësor të formës së prerë (Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gllogoc, C. nr. 80/05, i 6 qershorit 2005 i formës së prerë nga 3 korriku 2006), ndërsa sa i përket çështjes së kërkesës për dëmin material Gjkata Themelore kishte konstatuar se kjo kërkesë ishte parashkruar.
55. Gjkata më tej konstaton se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, duke refuzuar padinë e parashtruesit në pjesën që ka të bëjë me shpërblimin material për dëmin e shkaktuar, kishte konstatuar se kërkesa është parashkruar duke arsyetuar se “*Me dispozitën e nenit 376 para. 1 të LMD-së të vjetër që ka qenë në fuqi kur pretendon se paditesit i është shkaktuar dëmi material parashihet kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që ka bërë dëmin, sipas parag. 2 të nenit të njëjtë parashihet sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për 5 vjet nga data kur është krijuar dëmi*”.
56. Në këtë drejtim, Gjkata gjithashtu konstaton se ishte vetë parashtruesi i kërkesës që në dosjen e lëndës e ka bashkëngjitur Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gllogoc, C. nr. 80/05, të 6 qershorit 2005, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 771/2005, të 3 korrikut 2006, nga të cilat qartazi shihet se çështja e pronësisë lidhur me banesën kontestuese është zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë. Aktgjykimet e përmendura ishin nxjerrë nga gjykatat sipas padisë së M. K., ku palë e paditur ka qenë parashtruesi i kërkesës dhe nga shkresat e lëndës konstatohet se parashtruesi i

kérkesës ka marrë pjesë personalisht në rastin e shqyrtimit të padisë dhe ka paraqitur provat e tij.

57. Megjithatë, Gjykata konstaton se, edhe përkundër fakteve të lartpërmendura, vetëm me Aktvendimin C. nr. 180/08, të 22 marsit 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc e kishte cilësuar rastin si “çështje të gjykuar” (*res judicata*) por që aktvendimi në bazë të ankesës së parashtruesit ishte anuluar nga Gjykata e Apelit për shkaqe procedurale.
58. Vendimet e mëpasshme gjyqësore nuk kishin pezulluar procedurat e mëtutjeshme bazuar në parimin e ‘çështje e gjykuar’. Në fakt, në Aktgjykimin e saj, kur kishte vendosur lidhur me meritat e padisë, Gjykata Themelore e kishte udhëzuar parashtruesin e kérkesës për mjetin juridik dhe këtë të drejtë ai e kishte shfrytëzuar më 26 shator 2018, duke dorëzuar një ankesë në Gjykatën e Apelit.
59. Për më tepër, Gjykata konstaton se ndaj këtij Aktgjykimi parashtruesi i kérkesës ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit dhe akoma nuk ka marrë një përgjigje, andaj në këto rrethana kérkesa është e parakohshme, gjegjësish nuk janë përbushur kushtet e parapara me nenin 113.7 të Kushtetutës lidhur me shterjen e të gjitha mjeteve juridike në kérkesat individuale.
60. Gjykata rithekson se arsyetimi i rregullit të shterimit të mjeteve juridike është t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korriguar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës.
61. Ky rregull bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 të Kushtetutës dhe në nenin 13 të KEDNJ-së, se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive për adresimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të sistemit të drejtësisë kushtetuese (shih rastin e GJEDNJ-se, *Civet kundër Francës*, Aktgjykim i 28 shtatorit 1990, paragrafët 42-44, ndër të tjera, rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI158/18, parashtrues *Ajet Ajeti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 prillit 2019, paragrafët 40-42; KI07/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2016, parografi 61).
62. Prandaj, për arsyet e përmendura më lart, Gjykata konstaton se kérkesa e parashtruesit nuk i plotëson kriteret për pranueshmëri pasi që parashtruesi i kérkesës nuk i ka shteruar mjetet juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 par. 2 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës.
63. Në rrethanat e rastit, kur kérkesa e parashtruesit është e parakohshme, Gjykata nuk mund të shqyrtojë pretendimin për shkelje të së drejtës së pronës aq më tepër kur çështja pronësore është objekt shqyrtimi në Gjykatën e Apelit të Kosovës.
64. Si përfundim, në përputhje me rregullin 39 (1) b kérkesa duhet të deklarohet e papranueshme për shkak të mosshterjes së mjeteve juridike të parapara me ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 22 korrik 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazeten Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi - Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

